



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 03-177-22;

Data: 14.06.2022

Në bazë të nenit 62 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L – 040 për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), nenin 57 shkronja e të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.2.2010, Drejtoria Komunale e Arsimit lëshon këtë:

NJOFTIM

Në konkursin nr. 03-176-22 të datës 13.06.2022 për regjistrimin e fëmijëve në institucionet parashkollore publike të Komunës të Prishtinës për vitin 2022/2023, është konstatuar se është përvjedhur një gabim teknik në IP "Fatosat" në grupmoshën 3-6 vjeç.

Nga IP "Fatosat" është evidentuar se numri "18" në grupmoshën 3-6 vjeç është gabim teknik dhe realisht ky numër do të duhej të jetë zero (0). Po ashtu, në pikën III të Konkursit tek numri i UA është përvjedhur numri katër (4) i UA, në vend se të ishte 3 (tre), ashtu siç është i përcaktuar në hyrje të konkursit.

Duke ditur se ky lëshim teknik ndikon në numrin e të regjistruarve në IP "Fatosat", ky njoftim është pjesë/shtojcë përbërëse e konkursit nr. 03-176-22 të datës 13.06.2022 për regjistrimin e fëmijëve në institucionet parashkollore publike të Komunës të Prishtinës për vitin 2022/2023.

Ju kërkohet ndjesë për gabimin e lëshuar.

Drejtoria Komunale e Arsimit

